

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6559
E martë, 15 mars 2022
çmimi 0.40 €

Ukraina, thirrje Perëndimit për më shumë armë

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

AKSIONI "PIKA" PËRFUNDON ME ARRESTIMIN E DHJETËRA ZYRTARËVE POLICORË

ARRESTOHEN 48 ZYRTARË POLICORË DHE DY DOGANIERË PËR RYSHFET

FAQE 4-5



Në një aksion të Inspektoratit Policor të Kosovës, të koduar "Pika", që është kryer të hënën me urdhër të Prokurorisë Speciale, janë arrestuar 48 policë dhe dy zyrtarë doganorë. Të arrestuarit dyshohen për veprat penale "marrje e ryshfetit" dhe "keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"

Shefi i BE-së takon liderët e opozitës, diskutohet për agjendën evropiane dhe reformën zgjedhore

FAQE 3



PROCESI GJYQËSOR NDAJ GUCATIT DHE HARADINAJT, DREJT FUNDIT

FAQE 4-5

OPINION

PËRKRAHENI UKRAINËN, POR MENDONI PAK EDHE PËR KOSOVËN!

F. 8

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE



EULEX-I DO TË PËRFORCOHET ME 92 PJESËTARË TË XHANDARMËRISË

F. 3

BIE NUMRI I RASTEVE TË REJA ME COVID DHE I TË VAKSINUARVE

F. 3

EKONOMI



BËHET PËRZGJEDHJA E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË GRANTEVE NGA KOMUNAT PËR VITIN 2022

F. 8

KOMUNAT PO BALLAFAQOHEN ME RITME TË ULËTA PËR VJELJEN E TË HYRAVE TË TATIMIT NË PRONË

F. 8

SPORT

MKRS-ja KËRKON PËR PROCES TË RREGULLT E TË BAZUAR NË NORMA STATUTARE TË ZGJEDHJEVE NË FFK

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net


INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina, thirrje Perëndimit për më shumë armë

KIEV, 14 MARS - Ministri i Jashtëm i Ukrainës, Dmytro Kuleba, i bëri thirrje Perëndimit që ta furnizojë Ukrainën me armë dhe të zbatojë më shumë sanksione kundër Rusisë, me qëllim që të parandalohet, siç tha, përfshirja e vendeve të tjera në një konflikt më të gjerë. Ukraina u ka kërkuar vazhdimisht aleatëve të saj që të bëjnë më shumë për ta ndihmuar atë që t'i rezistojë pushtimit rus. Presidenti rus, Vladimir Putin, ka dhënë urdhrin për pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt. Disa qeveri perëndimore kanë shprehur frikën se një veprim i tillë mund të tërheqë vende të tjera në luftë, përfshirë vendet anëtare të NATO-s. "Për ata jashtë vendit [Ukrainës] që kanë frikë se mund të tërhiqen në një Luftë të Tretë Botërore... Ukraina po lufton me sukses. Ne kemi nevojë që ju të na ndihmoni të luftojmë. Na i

Çernobili mbetet sërish pa rrymë

Ish-termocentrali bërthamor i Çernobilit në Ukrainë ka mbetur sërish pa energji elektrike pasi forcat ruse dëmtuan për herë të dytë linjën e tensionit të lartë në termocentral, tha kompania kombëtare e energjisë në Ukrainë, Ukrenergo. Kompania tha përmes një deklarate se linja, e cila furnizon me energji elektrike edhe qytetin Sllavutiç, është dëmtuar përsëri nga forcat ruse, pasi ekuipazhi i Ukrenergos e ka riparuar atë. Termocentrali është shkëputur plotësisht nga rrjeti elektrik javën e kaluar. Kjo ndërprerje ka vënë në rrezik rreth 20 tonë mbeturina bërthamore, që duhet të ftohen vazhdimisht, për të penguar rrjedhjen e tyre nga uzina, e cila ndodhet rreth 100 kilometra larg kryeqytetit të Ukrainës, Kiev.



të ashpra" nëse e ndihmon Rusinë për pushtimin e Ukrainës, raportojnë mediet amerikane. Zyrtarë të paignifikuar raportohet se u kanë thënë medieve të shumta amerikane

televiziv CNN, këshilltari për siguri kombëtare i ShBA-së, Jake Sullivan, tha se Uashingtoni "po komunikon drejtpërdrejt dhe privatisht me Pekinin" dhe se ai do të ketë "pasoja të ashpra" nëse mbështet Rusinë.

dënuar ashpër veprimin rus dhe ka vendosur një sërë sanksionesh kundër Rusisë.

Kadyrov raportohet se ka shkuar në Ukrainë

Lideri çeçen Ramzan Kadyrov raportohet se ka udhëtuar për në Ukrainë, ku anëtarët e milicisë së tij besohet se po luftojnë përkrah forcave të rregullta ruse.

Një televizion, që kontrollohet nga administrata e Kadyovit në Çeçeni, ka postuar një video në "Telegram" më 13 mars, duke thënë se Kadyrov ishte në Ukrainë edhe pse nuk tregoi vendndodhjen e saktë se ku ishte bërë videoja.

Kadyrov ende nuk e ka konfirmuar se gjendet në Ukrainë. Megjithatë, dihet se njësitë e tij të Gardës Kombëtare të Çeçenisë janë dërguar në Ukrainë. Në video Kadyrov shfaqet duke u takuar me ushtarë të cilët i tregojnë për luftimet. Ndërkaq, në prapavijë shihet fotografia e babait të Kadyrovit, Akhmadit. Në këtë video, Kadyrov flet pak, teksa ushtarët tregojnë se si njësisia ka marrë kontrollin e një jetimoreje shtatë kilometra larg Kievit.

Videoja është titulluar: "Kreu i Republikës Çeçene Ramzan Kadyrov së bashku me luftëtarët që po marrin pjesë në operacionin e posaçëm ushtarak në Ukrainë". Mediet kanë raportuar gjerësisht për pjesëmarrjen e luftëtarëve çeçenë në Ukrainë, teksa janë publikuar video dhe fotografi të tyre që dëshmojnë pjesëmarrjen në këtë luftë. Njësitë paramilitare çeçene gjerësisht konsiderohen si forca të frikshme ushtarake. Në të kaluarën janë dislokuar, gjoja me autorizimin e qeverisë, në lindje të Ukrainës, por edhe në shtetet e tjera si Siria.



siguroni të gjitha armët e nevojshme. Zbatoni më shumë sanksione kundër Rusisë dhe izoloni atë plotësisht! Ndihmojeni Ukrainën që ta detyrojë Putinin të dështojë dhe do ta shmangni një luftë më të madhe", ka shkruar Kuleba në "Twitter". Perëndimi është duke e ndihmuar Ukrainën me armatim dhe financa. Përkundër thirrjeve të Ukrainës, Perëndimi e ka përjashtuar mundësinë e vendosjes së ndalim-fluturimit mbi Ukrainë, nga frika se një gjë e tillë do të mund të shkaktoje një Luftë të Tretë Botërore.

Javën e kaluar gjeneratorët emergjentë u aktivizuan menjëherë.

Forcat ruse morën kontrollin e Çernobilit menjëherë pasi shteti rus nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.

Ukrenergo kërkoi qasje në zonë për të bërë riparime.

Ukrenergo tha se Çernobili "është një strukturë e rëndësishme, që nuk mund të lihet pa furnizim me energji".

ShBA paralajmëron Kinën që të mos e ndihmojë Rusinë

Shtetet e Bashkuara thanë se Kina do të përballet me "pasoja

se Rusia i ka kërkuar Kinës t'i ofrojë ndihmë ushtarake.

Ambasada kineze në Uashington tha se nuk është në dijeni për këtë kërkesë.

Në një intervistë për rrjetin



Dy seanca këtë javë, njëra për rritjen e çmimeve

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, në mungesë kuorumi, ka shtyrë për një ditë tjetër mbledhjen e cila ishte paraparë të mbahet të hënën. Megjithatë, në kuadër të kompetencave të tij, kryeparlamentari Glauk Konjufca vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme, sipas kërkesës së grupit parlamentar të LDK-së, të mbahet sot (martë) në orën 11:00.

Në këtë seancë do të zhvillohet debat parlamentar lidhur me rritjen e çmimeve. Po ashtu, kreu i Kuvendit, Glauk Konjufca, mori vendim edhe për mbajtjen e seancave të papërfunduara. Lidhur me këtë ai vendosi që të mërkurën, nga ora 10:00, Kuvendi t'i shqyrtojë pikat nga seancat e papërfunduara, si në vijim: Pika e papërfunduar nga seanca e jashtëzakonshme, e

mbajtur më 24 dhe 26 janar 2022, (votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me shtrenjtimin e energjisë elektrike), pika e papërfunduar nga Seanca e Jashtëzakonshme, e mbajtur më 9 shkurt 2022, (votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me vendimin e ZRRE-së për rritjen e çmimit të energjisë elektrike).



EULEX-i do të përforcohet me 92 pjesëtarë të xhandarmerisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MARS - Një Njësi Policore e Specializuar Rezervë, e përbërë prej 92 pjesëtarëve të Forcës Evropiane të Xhandarmerisë (Eurogendfor) nga Portugalia, Franca dhe Italia, do të zbarkojë përkohësisht në Kosovë gjatë javëve në vijim për t'i përforcuar kapacitetet e Njësisë Policore të Specializuar të EULEX-it (NjPS).

NjPS-ja rezervë do ta mbështesë EULEX-in për përmbushjen e detyrave të tij, si reagues i dytë i sigurisë së Kosovës nëse është e nevojshme, duke pasur parasysh mjedisin e sigurisë.

NjPS-ja e EULEX-it është reaguesi i dytë i sigurisë së Kosovës si pjesë e një mekanizmi treshresor të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë, EULEX-i është reaguesi i dytë dhe KFOR-i është reaguesi i tretë i sigurisë.

NjPS-ja e rregullt e EULEX-it aktualisht përbëhet prej 105 zyrtarëve policorë nga Polonia të stacionuar në Mitrovicë. NjPS-ja Rezervë e siguruar nga Eurogendfor përbëhet prej 92 xhandarmëve: 42 nga Portugalia, 28 nga Franca dhe 22 nga Italia. Ata do të vendosen në Kompleksin e EULEX-it për Mbështetje në Fushë-Kosovë dhe do të jenë nën komandën e EULEX-it. Një ekip paraprak është paralajmëruar se do të mbërrijë më 14 mars.

Zbarkimi i NjPS-së rezervë dëshmon vendosmërinë e EULEX-it për ta vazhduar mbështetjen e stabilitetit të Kosovës dhe për të kontribuar për sigurinë e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Forca Evropiane e Xhandarmerisë është forcë policore shumëkombëshe, operationale, e para-organizuar, e fuqishme dhe shpejt e zbarkueshme.



Bie numri i rasteve të reja me Covid dhe i të vaksinuarve

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 14 MARS - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit, prej 812 testimeve, 18 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19.

Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar asnjë rast i vdekjes.

Të hënën janë shënuar edhe 54

qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 223 096.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 637.

Në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës po trajtohen dhjetë pacientë të konfirmuar me Covid-19.

Në trajtim mjekësor janë nëntë pacientë të tjerë post-Covid.

Me oksigjeno-terapi janë 12 pacientë, kurse në Mjekim

Intensiv po trajtohen katër pacientë.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 45 doza të vaksinës kundër Covid-19.

Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 817 741 doza të vaksinës.

Deri më sot 818 361 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 637 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covidit.

Intervista me shkrim e kandidatëve për gjyqtarë të Kushtetueses do të mbahet më 29 mars

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Komisioni i posaçëm për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese është mbledhur të hënën për t'i shqyrtuar nominimet e kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me përmbushjen e kushteve të


parapara me Kushtetutë dhe ligj.

Komisioni i posaçëm, i kryesuar nga deputeti Adnan Rustemi (i autorizuar nga kryetari i Kuvendit), pas shqyrtimit të të gjitha aplikacioneve të kandidatëve që kanë aplikuar për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese,

vlerësoi se të gjitha nominimet, 13 sosh, i plotësojnë kushtet e parapara.

Komisioni vendosi që pas shqyrtimit të aplikacioneve, të fillohet me fazën e parë të intervistimit. Intervista me shkrim u caktua të mbahet më 29 mars në orën 10:30.





AKSIONI "PIKA" PËRFUNDON ME ARRESTIMIN E DHJETËRA ZYRTARËVE POLICORË

Arrestohen 48 zyrtarë policorë dhe dy doganierë për ryshfet

Në një aksion të Inspektoratit Policor të Kosovës, të koduar "Pika", që është kryer të hënën me urdhër të Prokurorisë Speciale, u arrestuan 48 policë dhe dy zyrtarë doganorë. Të arrestuarit dyshohen për veprat penale "marrja e ryshfetit" dhe "keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar"

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 MARS - Kryeshefi i Inspektoratit të Policisë së Kosovës, Kushtrim Hodaj, ka thënë se të arrestuarit dyshohet se kanë marrë pjesë në qindra aktivitete të marrjes së ryshfetit në pikat kufitare të Qafë-Prushit dhe Qafë-Morinës. "Nga hetimet dyshohet se të arrestuarit janë të përfshirë qindra herë apo në mbi 400 veprimtari kriminale të marrjes së ryshfetit dhe keqpërdorim të detyrës zyrtar", ka pohuar Hodaj në një konferencë për medie mbajtur pas përfundimit të aksionit të koduar "Pika", që u nisi mëngjesin e 14 marsit në Gjakovë dhe Prizren.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë se prej majit të vitit të kaluar kanë filluar hetimet për këtë rast, pasi kanë marrë informacionet e para për dyshimet për përfshirjen e policëve dhe doganierëve në

veprimtari kriminale. Ai ka thënë se hetimet janë zhvilluar ndaj 68 personave. "Sot jemi njoftuar se janë arrestuar 50 zyrtarë shtetërorë, 48 nga Policia e Kosovës dhe dy nga shërbimi doganor i Kosovës. Personat e tjerë ndaj të cilëve është nxjerrë aktvendimi për fillimin e hetimeve janë në arrati, disa edhe nuk janë shtetas të Kosovës. Por, në këtë drejtim jemi duke bashkëpunuar edhe me autoritetet e Republikës së Shqipërisë për të siguruar informacione dhe prova, që do të na shërbejnë për procedurë penale edhe në Kosovë dhe Shqipëri", ka thënë ai.

Në mesin e të arrestuarve, sipas IPK-së, janë dy togerë policorë, pesë rreshterë dhe dy zyrtarë doganorë. Inspektorati ka bërë me dije se të dyshuarit janë në ndalim prej 48 orësh dhe është rekomanduar që policët të suspendohen nga puna.

Ky operacion i IPK-së, sipas autoriteteve, është përkrahur edhe

nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Dogana e Kosovës dhe Policia e Kosovës.

Ndërkaq drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Samedin Mehmeti, ka thënë se siguria në pikat kufitare është në nivelin maksimal, teksa ka bërë me dije se tashmë janë zëvendësuar zyrtarët policorë që janë arrestuar. "Fakti që policia dhe institucionet e shtetit e kanë vullnetin që ta luftojnë korrupsionin, nënkupton që ne duhet të ndihemi mirë. Nuk është ndjenjë e mirë kur korruptohen zyrtarët policorë. Ky hetim ka nisur që një vit. Siguria në pikat kufitare është në nivelin maksimal. Sot duhet të ndihemi më mirë se dje për shkak se janë arrestuar zyrtarët policorë të korruptuar. Ata tashmë janë zëvendësuar", ka deklaruar ai. Mehmeti ka thënë se puna në pikat kufitare është duke u zhvilluar në mënyrë normale.

Në lidhje me këtë aksion ka reaguar ministri i Punëve të

Brendshme, Xhelal Sveçla. Ai ka përgëzuar Inspektoratin Policor të Kosovës dhe institucionet vartëse të MPB-së të cilët me seriozitet dhe ndershmëri punojnë maksimalisht në shërbim të qytetarëve dhe në përmirësimin e shërbimeve ndaj tyre. "Qëllimi ynë kryesor është të garantojmë integritet dhe profesionalizëm brenda të gjitha agjencive që drejtojmë. Në kuadër të kësaj, kushdo që cenon integritetin e institucionit, pa dyshim do të përballet me drejtësinë sipas ligjeve në fuqi", ka shkruar Sveçla në llogarinë e vet në "Facebook".

Pavarësisht kësaj, ai ka thënë se Policia e Kosovës renditet si institucioni i dytë më i besueshëm për qytetarët dhe kjo natyrisht është falë punës së zyrtarëve policorë dhe jo vetëm. "Ne jemi zotuar që këtë vlerësim do ta ruajmë dhe do të punojmë maksimalisht që ta ngrehim më lart. Në kuadër të kësaj, të gjithë ata që tentojnë apo e njojnë punën e ndershme dhe profesionale të zyrtarëve të tjerë policorë, nuk kanë vend në Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës nuk do të jetë më asnjëherë vendi ku thyhet ligji e bëhet korrupsioni. Si ministër i

Punëve të Brendshme do të vazhdoj ta jap mbështetjen time maksimale për secilin zyrtar policor veç e veç dhe për policinë në tërësi për arritjen e qëllimeve të tyre madhore për të garantuar rend, ligj e siguri për të gjithë qytetarët në tërë territorin e Republikës së Kosovës", ka thënë ministri Sveçla. Edhe ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka reaguar lidhur me aksionin "Pika". Haxhiu ka thënë se ende kemi sfida, mirëpo kemi vullnetin e hekurt për ta bërë vendin e jetueshëm për qytetarët. "Në të kaluarën institucioneve të sigurisë dhe drejtësisë nuk i janë lënë duart e lira për veprim. Në shumë raste ekzekutivi ka qenë pengesa kryesore në luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sot kemi ende sfida, mirëpo kemi vullnetin e hekurt për ta bërë vendin e jetueshëm për qytetarët", ka shkruar Haxhiu në llogarinë e saj në "Facebook". Ajo ka theksuar se mbështetja e qeverisë në aksione të tilla është e pazezervë. "Përsëritës aksionin e përbashkët të institucioneve për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Mbështetja e qeverisë sonë në raste të tilla është e pazezervë", ka pohuar Haxhiu.

Procesi gjyqësor ndaj Gucatit dhe Haradinajt, drejt fundit

Të hënën në Gjykatën Speciale, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka filluar dhënien e deklaratës përmbyllëse në rastin gjyqësor ndaj Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt. Me këtë rast, prokurorja Valeria Bolicci para trupit gjykues ka thënë se Gucati dhe Haradinaj, para se të arrestoheshin, kanë ndërmarrë veprime për zhbërjen e

Speciales. Në këtë kontekst, ajo ka thënë se ka prova të mjaftueshme për dënimin e tyre. Ndërsa kryetari i trupit gjykues në fillim të seancës ka bërë me dije se sot (e martë) dhe nesër (e mërkurë) mbrojtja e Gucati dhe Haradinajt do ta kenë rastin për t'i dhënë deklaratat e tyre përmbyllëse

HAGË, 14 MARS (ER) - Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) të hënën ka filluar dhënien e deklaratës përmbyllëse në gjykimin ndaj kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Gucati dhe zëvendësit të tij, Nasim Haradinaj. Me këtë rast, prokurorja e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS), Valeria Bolicci, ka thënë se Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj kishin ndërmarrë veprime që ta zhbënin Gjykatën Speciale. "Në 15 paraqitje publike dhe deklarata të akuzuarit kanë deklaruar se ata po i kryenin këto veprime në mënyrë që të shpërbënin këtë gjykatë, pra të zhbëhet kjo gjykatë", ka thënë Bolicci.

Po ashtu, ajo ka deklaruar se në qoftë se faktet e kësaj çështjeje penale nuk injorohen dhe nuk keqinterpretohen ligji i zbatueshëm, do të pranohet përgjegjësia penale e të akuzuarve si shumë e qartë. Sipas saj, mbrojtja e di shumë mirë këtë, prandaj e argumenton se të akuzuarit duhet të shfaqësohen nga përgjegjësia penale bazuar mbi një numër mbrojtjesh të sajura, të cilat, sipas saj, nuk bazohen në dispozita të shëndosha.

Prokurorja Bolicci ka theksuar se gjatë gjithë këtij gjykimi të akuzuarit janë përpjekur që ta paraqitnin veten si përfaqësues dhe flamurtarë të një drejtësie të lartë, një version modern i "Antigonës". "Ata thonë se nuk duhet të ndëshkohen sepse duke shkelur ligjin ata ndoqën synimet e drejtësisë që i kanë përkufizuar ata vetë. Ne këtu nuk do të përfshihemi në thënie se pse ligji për mbrojtjen e sekretit të hetimeve, privatësisë, sigurisë, dinjitetit, mirëqenies së dëshmitarëve janë të



domosdoshme dhe të drejtpërdrejtë. Ne, gjithashtu, nuk do të diskutojmë se pse nëse të akuzuarit në fakt u përpoqën të ndjekin apo të zbatojnë interesat e një grupi individësh kundër interesave të shoqërisë që bazohen në ligj", ka thënë ajo.

Më tutje, Bolicci ka thënë se provat kundër Gucati dhe Haradinajt janë bindëse. Siç ka theksuar ajo në video-incizime, ata shihen dhe dëgjohen duke e shprehur me fjalë qëllimin e tyre "kriminal" në mënyrë të hapur dhe të ashpër dhe të përsëritur. "Mbetet e pakundërshtuar se të dy kanë bërë tri konferenca shtypi më 7, 16 dhe 22 shtator 2020. Nuk është kundërshtuar se ata kanë shpallë se kishin në posedim

dokumente konfidenciale që i përkisnin TFH-së dhe ZPS-së që përmbanin emra dhe të dhëna personale të dëshmitarëve të mbrojtur si dhe nuk kundërshtohet se ata kanë shpallur se kanë dhënë këto informacione konfidenciale aty që ishin të pranishëm dhe të gjithë publikut, është e incizuar se ata iu drejtuan dëshmitarëve ose i quajtën dëshmitarët dhe ata që bashkëpunuan me këtë gjykatë si tradhtarë, gënjeshtarë, spiunë dhe bashkëpunëtorë dhe ata thanë që këta dëshmitarë nuk mund të mbroheshin më", është shprehur ajo.

Sipas prokurorës së ZPS-së, pjesa tjetër e provave që janë paraqitur në gjykatë plotësojnë dhe vulosin

provën për përgjegjësinë e të akuzuarve për të gjitha krimet në aktakuzë përtej dyshimit të arsyeshëm. "Provata shtesë erdhën jo vetëm nga dëshmitarët të paraqitur nga ZPS-ja, por papritur dhe në mënyrë shumë domethënëse edhe nga dëshmitarët që paraqitën nga mbrojtja sa herë që dëshmitarët e mbrojtjes u përballën me faktet që lidheshin me akuzat, ata nxorën prova inkriminuese njëra pas tjetrës, duke filluar edhe nga vetë të akuzuarit", ka thënë prokurorja Bolicci.

Ndërsa kryetari i trupit gjykues, Charles L. Smith II, ka bërë me dije sot (e martë) dhe nesër (e mërkurë) pritet që avokatët mbrojtës të Hysni Gucati dhe

Nasim Haradinaj t'i paraqesin deklaratat e tyre përmbyllëse.

Më pas, sipas tij, më 17 mars do të pasohet me përgjigjet si dhe parashtrimet e ZPS-së lidhur me dënimin, kurse më 18 mars do të vazhdohet me parashtrimet e mbrojtjes lidhur me dënimin dhe me deklaratat e të akuzuarve.

Hysni Gucati së bashku me Nasim Haradinajn janë duke u akuzuar për veprat penale kundër administrimit të drejtësisë, konkretisht për pengim të personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, për frikësim të dëshmitarëve, për hakmarrje dhe për shkelje të fshehtësisë së procedurës. Këto akuzat janë mohuar në vazhdimësi nga Gucati dhe Haradinaj.

Shefi i BE-së takon liderët e opozitës, diskutohet për agjendën evropiane dhe reformën zgjedhore

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, ka takuar të hënën liderët e partive opozitare në Kosovë. Szunyog takimet i nisi me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, me të cilin ka diskutuar për agjendën e reformës evropiane. "Diskutim thelbësor me kryetarin e PDK-së, Memli Krasniqi, mbi zhvillimet e fundit në Kosovë dhe rolin e opozitës për avancimin e agjendës së reformës evropiane. Partitë politike duhet të fokusohen në çuarjen përpara të reformës zgjedhore të vonuar prej kohësh



dhe në miratimin e legjislacionit evropian përkatës për të mirën e të gjithëve" ka shkruar Szunyog në llogarinë e vet në "Twitter".


Krasniqi e ka falënderuar ambasadorin Szunyog duke thënë se anëtarësimi i Kosovës në BE mbetet prioritet për

Kosovën dhe qytetarët e saj. "Faleminderit ambasador! Rruga e Kosovës drejt integritimit në BE mbetet prioritet për qytetarët e Kosovës dhe PDK-ja do të vazhdojë të luajë rol thelbësor për arritjen e këtij qëllimi të rëndësishëm", ka shkruar Krasniqi në "Facebook". Ambasadori Szunyog, pas Krasniqit, ka takuar kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku. "Kënaqësi të diskutojmë një sërë çështjesh me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku. Roli i opozitës është i rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së dhe për

reformën zgjedhore. Vetëm reformat gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në konsensus janë të qëndrueshme dhe të suksesshme", ka shkruar Szunyog.

Shefi i BE-së në fund ka takuar edhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj. "I lumtur ta dëgjoj përkushtimin dhe gatishmërinë e liderit të AAK-së, Ramush Haradinaj, për t'u angazhuar në reformën zgjedhore. Mosmarrëveshja në dy nene nuk duhet të jetë arsyeja për të mos miratuar një Kod Civil shumë të nevojshëm", është shprehur Szunyog.

Përkraheni Ukrainën, por mendoni pak edhe për Kosovën!



Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA

Analfabetë vendorë, “ekspertë” ndërkombëtarë: Është thuaja si rregull që popujt e vegjël e që nuk janë në gjendje t’i zgjidhin as problemet më të vogla brenda vendit apo shtetit ku sundojnë, për udhëheqës kanë personalitete apo individë që kryesisht merren me tema të mëdha të politikës globale përkatësisht sillen sikur të jenë kunxhi rreth të cilit sillet krejt bota, universi dhe toka. Në paraqitjet e tyre për t’u dukur sa më të mençur, as që përmendin problemet e popullit nga i cili janë shkëputur sa kanë ardhur në pushtet, jo vetëm kjo qeveri por thuaja të gjitha. Disa prej tyre, mangësitë e njohurive politike dhe intelektuale përkatësisht përmbajtjen boshe e fshehin me një perde të jashtme në formë të veshjes moderne, sa për përshtypje vizuale ndërsa të tjerët, nuk i kushtojnë edhe aq shumë rëndësi veshjes sa i kushtojnë rëndësi përpjekjeve për të lënë përshtypje se janë shumë të mençur. Kemi raste që dikush e lidhë kollaren si të ishte nyje e kapistrës me të cilën lidhet gomari kurse, dikush tjetër, si Dastin Hofmani e përdorë kravatinë flutur, ndonëse e luan një rol të padenjë edhe për një komedi në nivel të një mëhale. Më kanë treguar një rast kur njëri që e konsideron veten Ajnshtajn të politikës kosovare me synime që të jetë edhe i politikës shqiptare, gjatë një vizite në një shtet të fuqishëm e që historikisht asnjëherë nuk ka qenë përkrahës i shqiptarëve, në sugjerimet e kryetarit të atij shteti se çfarë veprimesh duhet të merren në mënyrë që bashkësia ndërkombëtare të fillojë t’i merr pak më seriozisht, ky fyelli ynë ka filluar t’i flasë për Revolucionin Borgjez Francez, rënien e Bastijës, Dekartin, Viktor Hygon, Robespierin, Dantonin etj. Dhe, si përfundim e ka marrë përgjigjen se e falënderon

shumë për vizitën dhe sidomos se paska ardhur t’ia mësojë historinë e Francës dhe të popullit francez.

Ky ekzibicionizëm për t’u paraqitur “më katolik se Papa”, ky perversion gjysmintelektual dhe puritanizëm imoral është shenjë identifikuese e një numri jo të vogël të politikanëve të Ballkanit me të cilin luajnë k.e politikantët që marrin vendime në nivel global duke i përdorur si kondomë buzë afatit të skadencës apo letër tualeti me një riciklim të një materiali shumë të dyshimtë. Po, kështu duan, dhe kështu e meritojnë sepse jetojnë dhe veprojnë për t’iu pëlqyer të tjerëve, për të marrë opinionin e ndërkombëtarëve duke injoruar bazën e tyre elektorale apo rrënjët njerëzore, kombëtare, politike dhe morale, nëse ende ndjejnë se janë pjesë të atij mjedisi.

“Ekspertët” për çështjen ruse, kineze, serbe dhe tash edhe ukrainase: Prej kabinetit të kryeministrit Kurti më së shumti më bënë përshtypje Donika Shvarc- Gërvalla që me këmbëngulje ia ka futur vetes në kokë se qenka ministre për Punë të Jashtme dhe Diasporë dhe, ndonëse me asnjë veprim nuk e ka dëshmuar se është e vërteta, madje me të gjitha veprimet ka dëshmuar se është huqje antologjike dhe historike, përsëri e luan të njëjtin rol! Ku të shkon flet si sinologe, rusologe, ukrainologe dhe serbologe, derisa të shkaktohet ndonjë krizë e re botërore e që duhet domosdoshmërisht të merret edhe me atë krizë, si eksperte universale dhe e pazëvendësueshme. Në vend se të merret me diskualifikimin ndërkombëtar të Kosovës nga të gjitha shtetet vendimmarrëse, zonja Shvarc-Gërvalla përpigjet ta bind botën se, sidomos kohëve të fundit paska një përafrim të marrëdhënieve midis Ruisë dhe Serbisë (të cilën askush nuk e ka ditur deri më tani) dhe se Rusia përmes Serbisë po e rrezikon veriu e Kosovës ku zonja Gërvalla nuk guxon të shkojë as më 8 mars dhe se, nëse nuk mbrohet Kosova, e pati demokracia, stabiliteti dhe siguria ndërkombëtare! Çfarë gjenialiteti apo profecie e Gjyshe Vangës gjermano-shqiptaro-kosovare! Jam i

bindur se edhe këshilltari politik i çerdhes politiko-ideologjike të Albin Kurtit, do të ishte më i zoti dhe më mirë do ta përfaqësonte Kosovën në politikën e Jashtme, nëse edhe mund të flasim se kemi politikë të jashtme, se Sizifja që aktualisht është në krye të kësaj ministrie e që, në vend se ta rrokullisë gurin (çështjen e Kosovës) lart, vetëm sa po e kthen poshtë e më poshtë! Kam shpresuar se kjo ministre, njëkohësisht edhe zv/kryeministre, më në fund do ta kuptojë se është kurdisur në kohë të gabuar dhe në vend të gabuar dhe se do të largohet, pa pasur nevojë të shkarkohet, mirëpo, siç thoshte dikur Gjilasi (një politikan i shquar jugosllav) “pushteti është pasioni më i madh...”, largimi nga pushteti, në rrethana aktuale dhe jo vetëm aktuale shkakton efekte zinxhirorë të frustracionit dhe shfrytërim të personalitetit. Dhe, largimi eventual nga posti të cilin me asgjë nuk e meritoni, për mentalitetin e baushtellës politike është e paimagjinueshme, derisa të lodhet Sizifi! Nuk është kjo e vetmja ministre e kryeministrit Kurti që duhet të shkojë në recycle bin mirëpo gjeografikisht është më afër shportës recikluese, se të tjerët. Dhe, jam shumë i sigurt se kjo vetëm sa do t’i bëjë mirë. Do të ketë më shumë kohë të merret me komandantët dhe politikanët e UÇK-së që janë robë paqeje në Hagë për shkak të luftës që e kanë bërë, të merret me UÇK-në që e ka trajtuar si një ushtri okupuese, të merret me të burgosurit politikë shqiptarë që i ka pasur halë në, jo vetëm njërin sy por në të gjitha shqisat dhe, edhe post mortem të merret me Bacën Adem. Dhe, pasi Ukraina ka nevojë për vullnetarë nga e gjithë bota dhe pasi për shkaqe objektive (të mosdurimit ndaj UÇK-së), ka mundësi të shkojë vullnetare në këtë shtet, në emër të mbrojtjes së vlerave demokratike universale, integritetit territorial të Ukrainës me Krimenë, Donbasin dhe Luhanskin brenda sepse veriu e Kosovës e ka integruar me shumë sukses, mbrojtjes së njerëzimit nga një agresion i një shteti siç është Rusia për të cilën Donika Shvarc-Gërvalla ka tërhequr vërejtjen para të gjithëve se po e trazon Ballkanin dhe të tjerave. Kontributi dhe ndihma

më e madhe për politikën e jashtme të Kosovës është që këtë post ta ketë dikush që merr vesh në këtë punë e që qartazi nuk e kemi një person të tillë aktualisht!

Mecenarizmi politikë dhe moral në rastin e Ukrainës: Rusia dhe Ukraina kanë qenë për një kohë të gjatë një shtet kurse pas shpërbërjes së perandorisë sovjetike Ukraina e fitoi një pavarësi të mbikëqyrtur nga Rusia. Më vonë, në vitin 2014 Rusia e pushtoi Krimenë për të njohur së voni Donbasin dhe Luhanskin, si republika shtete të pavarura nga Ukraina por të varura 100 për qind nga Rusia. Kjo njohje e banana shteteve të Donbasit dhe Luhanskit provokoi intervenimin në cilësinë e “paqeruajtësit” të Ruisë e që po përhapet në tërë Ukrainën. Shqiptarët historikisht kanë pësuar nga të gjithë e më së shumti nga Serbia e cila është fëmijë, jo i birësuar por real politik, fetar, moral dhe kulturor i Ruisë andaj nuk ka asgjë më e natyrshme të përkrahet e drejta e Ukrainës për shtet, liri dhe pavarësi. Mirëpo, duhet të thuhet qartazi se lufta në Ukrainë nuk është as e Kosovës e as e kosovarëve apo shqiptarëve, për të shkuar në luftë atje. Kosova e ka Donbasin, Luhanskin dhe Krimenë brenda territorit të saj e që nuk po ka mundësi t’i zgjidhë, për të luajtur rol të madh në këtë luftë të padrejtë siç po pretendon presidentja Osmani, disa ministra dhe vet kryeministri Albin Kurti. Janë shtëllunga mashtrimesh se tani do të bëhemi anëtarë të NATO-s, BE-së dhe Këshillit të Evropës, siç po deklarojnë disa politikanë kur, në po këtë kohë as vizat nuk po i heqin, madje e kanë futur Kosovën në një izolim ndërkombëtar duke bojkotuar takimet në nivelin më të lartë sidomos me kryeministrin Kurti. Realisht, të gjitha këto i kushtëzojnë me “përparimin përmbajtësor të procesit të bisedimeve me Serbinë”, “marrjen e vendimeve të guximshme”, “pranimin e kompromisit të dhimbshëm për Kosovën” etj. Është e mërzitshme përsëritja e përditshme e presidentes Osmani se Serbia donë ta merr veriu e Kosovës me ndihmën e Ruisë, se veriu është nën kontroll të paramilitarëve politikë të Serbisë dhe Kosovës dhe, së fundi se presidenca e Kosovës e gjykon ashpër

pjesëmarrjen e serbëve në krah të Ruisë në luftë kundër Ukrainës... Nuk ka takim e që nuk përmendet frika nga ndikimi i Ruisë, përmes Serbisë në Kosovë, dhe nga pozita e një lypsari kërkohet që të intervenohet dhe mbrohet Kosova në kohën kur, po edhe vetëm një uniformë e NATO-s të varet në një pemë të veriut, Serbia nuk do t’i mësyjë Kosovës. Kjo është e qartë edhe për analfabetët e politikës rurale! Tjetër çështje është nëse në kombinimet për zgjidhje të çështjes së Kosovës, vendimmarrësit botërorë do t’i lejojnë Serbisë një intervenim të sforcuar ushtarak për të marrë atë territor që mendojnë se i takon Serbisë e që pastaj do të konkretizohet përmes bisedimeve politike apo në ndonjë konferencë ndërkombëtare. Prandaj, udhëheqësit politikë të Kosovës duhet ta përkrahin Ukrainën por se duhet të punojnë më shumë për “ukrainasit” e Kosovës, në veri të Kosovës, në radhë të parë por edhe në pjesët tjera të Kosovës që, përveç problemeve të sigurisë përballen edhe me probleme të natyrës ekzistenciale për shkak të gjendjes ekonomike të rënduar. E rilexova intervistën e ambasadorit të Ukrainës në Beograd ku shprehimisht dhe qartazi thotë se Ukraina nuk e ka ndërruar dhe as nuk do ta ndryshojë qëndrimin për njohjen e pavarësisë së faktin e se njeh integritetin territorial të Serbisë, me Kosovën brenda këtij integriteti territorial. Tash, “ukrainasit” e politikës kosovare gjejnë dhe do të gjejnë arsytim se ambasadori ukrainas në Beograd, për shkak të ndjeshmërisë së situatës nuk guxon të flasë ndryshe por, mendoj se formulimi i tij do të duhej të ishte më diplomatik e jo të flasë njëjtë si Aleksandar Vuçiqi, Vulini dhe Daçiqi. Në fund të fundit, mosnjohja e pavarësisë së Kosovës nuk do t’ia kthejë Ukrainës as Krimenë, as Donbasin e as Luhanskin. Për këtë nuk kam asnjë dyshim! E drejta që nuk mbështetet me forcë është kategori morale dhe asgjë tjetër. Prandaj, udhëheqësit e Kosovës, pozitë dhe opozitë duhet ta kenë të qartë se lypësi nuk e merr atë që e kërkon, por atë që ia falin të fuqishmit. Prandaj, të gjithë duhet dhe do ta përkrahim Ukrainën, por duhet dhe do të punojmë për Kosovën për të mos lejuar që Kosova të bëhet Ukrainë!

Klinika Emergjente ofroi ndihmë mjekësore për 65 mijë pacientë në 2021-n



PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Klinika Emergjente në Qendrën Klinike Universitare e Kosovës ka ofruar ndihmë mjekësore për 65 344 pacientë gjatë vitit 2021. Nga numri i përgjithshëm, në Dhomën e

Reanimimit (Dhoma e Kujdesit të Avancuar Emergjent), brenda periudhës janardhjetor u trajtuan 16 799 pacientë. Sipas raportit vjetor të punës, 10 983 pacientë morën shërbime mjekësore kirurgjike,

kurse në Dhomën e Internos u trajtuan 18 821 pacientë. Kishte edhe 13 837 raste të natyrës ortopedike, përdorisa 4 479 persona kërkuar ndihmë mjekësore si pasojë e aksidenteve në trafik.

Ukraina falënderon Kosovën për mbështetje

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 MARS - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kreshnik Ahmeti, ka zhvilluar të hënën një telefonatë me homologen ukrainase Emine Dzhaparova. Në këtë bisedë Ahmeti e ka njoftuar Dzhaparovën për rreshtimin e Republikës së Kosovës për përkrahje të pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës. Ai ka përmendur sanksionet të cilat Kosova tashmë i ka vendosur dhe gatishmërinë për t'i shtuar ato në koordinim me ShBA-në, BE-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtare.

MPJD-ja ka njoftuar se Ahmeti ka përmendur edhe ndihmën që Republika e Kosovës po e ofron në këtë situatë duke strehuar 20 gazetarë, duke larguar përkohësisht regjimin e vizave për qytetarët ukrainas dhe duke treguar gatishmëri për strehimin e 5 000 refugjatëve.

Dzhaparova ka falënderuar Republikën e Kosovës për mbështetjen dhe për rreshtimin e menjëhershëm në anën e Ukrainës.



Kreshnik Ahmeti

Zëvendësministër i Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Emine Dzhaparova

Zëvendësministre e Punëve të Jashtme

Nga Ukraina ajo e njoftoi Ahmetin për situatën e rëndë humanitare të shkaktuar nga agresioni ushtarak i Federatës Ruse dhe për rezistencën e fortë

që po e bëjnë ukrainasit. "Kriza humanitare e shkaktuar nga Federata Ruse, veçanërisht në qytete si Mariupol, ku qytetarët po mbahen peng nga rrethimi

rus, po thellohet çdo ditë e më shumë", ka njoftuar MPJD-ja. Zëvendësministri Ahmeti përcolli ngushëllimet e sinqerta të Qeverisë së Republikës së

Kosovës për viktimat e agresionit rus dhe të dy u pajtuan që t'i vazhdojnë komunikimet e rregullta për bashkëpunim të mëtutjeshëm.

Universiteti 'Fehmi Agani' arrin marrëveshje me Universitetin Sapienza të Romës



GJAKOVË, 14 MARS (ER) - Rektori i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë, Artan Nimani dhe rektorja e Universitetit Sapienza të Romës, Antonela Polimeni, kanë rënë dakord për nënshkrimin e marrëveshjes për shkëmbim të studentëve në mes të këtyre dy universiteteve. Në këtë marrëveshje janë bërë me dije edhe rregullat e procedurave të shkëmbimit të studentëve: Zgjedhja e studentëve - të identifikohen studentët e përshtatshëm për të

marrë pjesë në programin e studimeve jashtë vendit; Kohëzgjatja e shkëmbimit nuk duhet të jetë më e shkurtër se tre muaj dhe as më shumë se një vit akademik; Të mbahet një ekuilibër i arsyeshëm në numrin e studentëve të shkëmbyer, dhe me këtë marrëveshje u vendos që numri maksimal i studentëve të jetë katër (ku do të lejohen të marrin pjesë në shkëmbim gjatë çdo viti akademik). Në bazë të kësaj marrëveshjeje

tarifat e shkollimit do t'i paguhen institucionit të origjinës. Studentët do të përfitojnë nga shërbimet e institucionit pritës si bibliotekat, laboratorët etj. Studentët do të jenë përgjegjës për t'i paguar të gjitha shpenzimet e tjera duke përfshirë shpenzimet e udhëtimit, ushqimit dhe akomodimit. Kjo marrëveshje ka një afat prej pesë vjetësh dhe mund të zgjatet ose ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje të ndërsjellë të palëve.

Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim, në prag të akreditimit ndërkombëtar

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Gjatë tetë ditëve Qendra e Kërkimit dhe Shpëtimit Ndërkombëtar e Mbretërisë së Bashkuar (UKISAR) dërgoi 18 anëtarë të Ekipit të të Vlerësimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (DART) për një stërvitje në Kosovë. DART është grupi i

parë i përgjigjes ndaj fatkeqësive përpara se ekipi kryesor i reaguesve të arrijë në vendngjarje. Edhe stërvitja përkatëse për stafin e Qendrës Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim dhe Shpëtim të FSK-së (QNTKSh) u realizua me skenar të ngjashëm për

përgjigjen e parë në fatkeqësi. Me këtë rast, UKISAR paraqiti certifikatën e njohjes për QNTKSh-në, një nga hapat përfundimtar për marrjen e akreditimit ndërkombëtar të QNTKSh-së si qendër trajnimit për kërkim-shpëtim në nivel botëror.



Bëhet përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit të Granteve nga komunat për vitin 2022

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 MARS - Kryeministri Albin Kurti ka kryesuar të hënën takimin e Komisionit të Granteve, në të cilin është bërë përzgjedhja e anëtarëve të rinj nga radhët e kryetarëve të komunave për Komisionin e Granteve për vitin 2022.

Në takim morën pjesë: ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci, ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi,

zëvendësministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Resul Makreshi, kryetari i Komisionit Parlamentar për Buxhet, Punë dhe Transfer, Armend Muja, si dhe kryetarët e komunave, të përzgjedhur me short vitin e kaluar: kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, kryetari i komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, si dhe kryetari i komunës së Parteshit, Dragan Petkoviç.

Qëllimi i këtij takimi ishte hedhja e shortit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Granteve nga Komunat për vitin 2022.

Zgjedhja e anëtarëve nga radhët



e komunave u bë përmes dy shorteve të veçanta, të cilat mbahen në bazë vjetore nga Komisioni i Granteve. Sipas procedurës, të gjitha komunat e Kosovës ishin të përfshira në short për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Komisionit të Granteve. Shorti u zhvillua në dy faza. Në fazën e parë ishte hedhja e shortit për përzgjedhjen e tre anëtarëve të rinj nga kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës, kurse në fazën e dytë

ishte hedhja e shortit për përzgjedhjen e një anëtar të ri nga kryetarët e komunave pakicë të Republikës së Kosovës. Anëtarët e rinj të Komisionit të Granteve nga komunat, të përzgjedhur me short për vitin 2022 janë: kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, kryetari i Vitisë, Sokol Haliti, kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni dhe kryetari i Novobërdës, Sasha Millosheviç. Komisioni i Granteve, sipas Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal,

është mekanizëm që përfshinë përfaqësues të institucioneve të ndryshme në nivelin qendror dhe lokal. Roli i komisionit është ta aprovojë grantin e përgjithshëm, si dhe grantet specifike për shëndetësi dhe arsim në nivelin lokal, gjë që reflekton mbi rëndësinë e punës së këtij komisioni. Parimet, kriteret dhe formulat e zbatuara për ndarjen e granteve qeveritare për financimin e komunave bazohen në këtë ligj

dhe tabelën e projeksioneve makro-fiskale, e cila përgatitet nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Komisioni i Granteve do të takohet sërish në muajin prill për të diskutuar dhe aprovuar financimin komunal për vitin 2023, gjithashtu orientimet për vitet 2024-2025, bazuar në prioritetet strategjike të qeverisë në fushën e marrëdhënieve fiskale ndërqeveritare.

Komunat po ballafaqohen me ritme të ulëta për vjeljen e të hyrave në tatimin në pronë

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Me qëllim shqyrtimin e planit të punës 2022 në përcaktimin e objektivave dhe aktiviteteve me interes për komunat në fushën e financave lokale, nën organizimin e Asociacionit të Komunave të Kosovës është zhvilluar takimi i Kolegjiut për Buxhet dhe Financa me pjesëmarrjen e Ahmet Ismailit, drejtor i Përgjithshëm i Thesarit (MFT).

Një ndër temat e diskutuara ishte edhe ajo e tatimit në pronë, ku komunat po ballafaqohen me ritme të ulëta për vjeljen e të hyrave në tatimin në pronë. Kjo u tha se rrjedh si pasojë e heqjes së kushtëzimit për regjistrimin e automjeteve, me pagesën e tatimit në pronë nga qytetarët. Përfaqësuesit komunalë u shprehën edhe një herë se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve e pohojnë të detyrueshëm pagimin e tatimit vetëm përmes kushtëzimit të regjistrimit të automjeteve personale. Andaj vendim unanimit i kolegjiut ishte edhe përpilimi dhe adresimi i kërkesës zyrtare te ministri i Financave për rishqyrtimin e këtij vendimi të mëhershëm.

Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit, Ahmet Ismaili, i ka informuar drejtorët e financave



lidhur me procesin e rrjedhës së parasë së organizatave buxhetore, proces ky i planifikuar që nga viti 2019, ashtu që të ketë një financim të balancuar të buxhetit, gjithnjë duke respektuar të drejtën që komunat e kanë për të destinuar këto mjete në kohën dhe projektet e caktuara.

Për shkak se ky proces është i ri në funksion, u tha se shumata e pashpenzuara do të barten duke marrë për bazë masat

lehtësuese fillestare deri më 15 korrik, ku edhe do të vazhdohet me masat e planifikuara sipas Rregullores për alokimin e fondeve dhe menaxhimin e rrjedhës së parasë. Po ashtu, një pikë kritike e diskutimit ishin edhe masat e reja të sigurisë lidhur me procedurat e regjistrimit të furnitorëve. "Për shkak të numrit të ulët të punëtorëve, ky proces është i ngadalshëm, andaj edhe duhet të kemi një mirëkuptim (për

dorëzim të kopjeve fizike) deri në momentin e regjistrimit fillestar në sistem për shkaqe të sigurisë", ka theksuar Ismaili. Ai ka thënë se ky proces do të shërbejë si filtër në sigurimin e të dhënave i cili pastaj mund të bartet dhe të shërbejë për vitet në vijim.

Një alternativë e mundshme ishte edhe rishikimi i dorëzimit të kopjeve fizike përmes postës së shpejtë te Thesari i Kosovës. Po ashtu, u tha se për shkak të

shtimit të masave të sigurisë në sistem do të ketë edhe kufizim në qasje nga personi i autorizuar me kredenciale të sigurisë.

Në këtë takim u theksua se nëse për shkak të shkaqeve të ndryshme personi nuk mund ta ushtronte detyrën atëherë, komunat duhet ta adresojnë personin i cili duhet të trajnohet - certifikohet përmes kërkesës së veçante te Thesari sepse nuk mund të kenë qasje dy persona në të njëjtën kohë.

Mbyllja e parajsave fiskale, testi i vërtetë i vendosmërisë së Perëndimit kundër Putinit



Nga Daron ACEMOGLU
"Project Syndicate"

Lufta e Rusisë në Ukrainë mund të mos shkojë siç ishte planifikuar, por më e keqja duhet ende të vijë. Dhe ndërsa sanksionet financiare të Perëndimit kundër institucioneve dhe oligarkëve rusë, kanë tejkaluar atë që prisnin disa, ato nuk kanë shënjestruar "rënjët" perëndimore të regjimit të presidentit rus Vladimir Putin.

Ashtu si tek shumë regjime të tjera kleptokratike, fuqia e Putinit bazohet tek një pakt midis një autokrati dhe oligarkëve. Autokrati e sundon vendin si të dojë dhe i pasuron aleatët e tij, të cilët grumbullojnë pasuri të mëdha nga burimet natyrore të vendit apo nëpërmjet monopoleve të sanksionuara nga regjimi.

Por ka një problem: ndërsa shtohen të ardhurat e oligarkëve, këta bëhen gjithnjë e më të shqetësuar mbi fuqinë e autokratit për të sekuestruar pasuritë e tyre apo për të dëmtuar familjet e tyre. Në këto kushte kanë në dispozicion 2 opsione.

I pari është zhvillimi i institucioneve formale dhe de facto për ta kufizuar autokratit, ndoshta edhe duke hapur rrugën reformave strukturore shumë të nevojshme. Opsioni i dytë është zhvendosja e pasurive dhe familjeve të tyre jashtë vendit, në mënyrë që të shmangin fatin e Mikhail Khodorkovsky, oligarkut kryesor rus, të cilin Putin e shpronësoi dhe e burgosi në fillimin e viteve 2000.

Shumë oligarkë rusë kanë shfrytëzuar opsionin e dytë, që nga ana e tij kërkon dy forma thelbësore të ndihmës nga Perëndimi. Së pari, sistemi bankar perëndimor duhet t'u ofrojë atyre lehtësi nëpastrimin e pasurive të tyre.

Londra, Zvicra, Luksemburgu, Qipro, Xhersej, Bahamas dhe shumë juridiksione më të vogla si Ishujt Kajman, e kanë përmbushur prej vitesh këtë kërkesë. Po ashtu edhe bankat evropiane kanë qenë pjesëmarrëse entuziaste në këtë proces. Madje edhe sistemi financiar i SHBA-së u ka ofruar të gjithëve oligarkëve infrastrukturën që u duhej.

Së dyti, kryeqendrat financiare perëndimore duhet të mirëpresin familjet e oligarkëve, duke i lejuar ata të blejnë prona (shpesh nëpërmjet kompanive guaskë), dhe të regjistrojnë fëmijët e tyre në institucionet arsimore më të mira. Qytete si Londra dhe Nju Jorku i kanë mirëpritur oligarkët dhe të afërmit e tyre në zemër të shoqërisë së lartë.

Është e arsyeshme të supozohet se aftësia e Putinit për të krijuar një autokraci personaliste, do të ishte kufizuar ndjeshëm në rast se elitat ruse nuk do t'i kishin pasur të hapura dyer në Perëndim. Por kjo nuk është vetëm një histori më ruse.

Të pasurit që vijnë nga shumë vende të tjera – përfshirë petro-shtetet e Gjirit, Kinën, Indinë, Turqinë, disa vende të Amerikës Latine dhe Ukrainën deri pak kohë më parë – kanë siguruar gjithashtu përfitimet e tyre të paligjshme me bashkëpunimin e

institucioneve financiare dhe qeverive perëndimore.

Këto marrëveshje jo vetëm që kanë ndihmuar në ruajtjen e regjimeve autokratike në Rusi dhe gjetkë, por ato kanë përfshirë edhe institucionet financiare dhe ekonomitë perëndimore. Paratë e oligarkëve i kanë transformuar tregjet financiare, duke injektuar sasi të mëdha likuiditeti, dhe duke e ndryshuar natyrën e ndërmjetësimit financiar, duke kontribuar në zgjerimin e pabarazive globale.

Që nga viti 1990, Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe disa vende të tjera perëndimore kanë deficit të mëdha të llogarisë korente, të financuara nga flukset e kapitalit nga pjesa tjetër e botës. Pas 3 dekadash, sasia e parave me origjinë të dyshimtë që qarkullojnë në sistemin financiar ndërkombëtar ka arritur përmasa gjigante.

Gabriel Zucman i Universitetit të Kalifornisë, vlerëson se të paktën 8 për qind e pasurisë financiare globale (më shumë se 7.5 trilion dollarë) ruhen tani në parajsat fiskale. Dhe këtu nuk përfshihen format e tjera të parave të dyshimta që ndodhen në zemër të sistemit financiar perëndimor.

Ndaj nuk është për t'u habitur që regjimet autokratike përbëjnë një pjesë disproporcionale të madhe të këtyre aktiviteteve të parave të pista. Zucman ka zbuluar se rreth 52 për qind e të gjithë pasurisë familjare në Rusi – dhe një sasi edhe më e madhe aksionesh në shtetet e Gjirit Persik – mbahen në parajsat fiskale.

Këto flukse të paligjshme, i kanë

thelluar problemet sociale dhe politike në mbarë botën. Kërkesa për banesa luksoze, ka nxitur një bum të rrezikshëm të pasurive të paluajtshme në Londër, Nju Jork dhe Vankuver.

Për shkak se pronat kryesore të paluajtshme në këto qytete, zotëroreshin tashmë kryesisht nga të pasurit, inflacioni që prodhohet nga rritja e çmimit të banesave e ka thelluar edhe më tej pabarazinë. Flukset e paligjshme financiare, kanë ndihmuar ndoshta edhe në bum-in e jashtëzakonshëm në tregjet perëndimore të aksioneve gjatë viteve të fundit, nga i cili kanë përfituar më tej të pasurit.

Por efektet më të dëmshme mund të shihen brenda institucioneve financiare dhe fiskale perëndimore. Pranimi i parave të pista nga Perëndimi, e ka përshpejtuar prirjen drejt strukturave më të errëta të pronësisë dhe skemave komplekse që synojnë shmangien e taksave, të mbështetura nga një infrastrukturë masive bankierësh, kontabilistësh dhe avokatësh në mbarë botën.


Kur Zucman dhe kolegët e tij analizuan të dhënat nga kontrollet e rastësishme, për të përcaktuar shkallën e evazionit fiskal në SHBA, ata arritën në përfundimin se 1 për qind e familjeve më të pasura amerikane, fsheh më shumë se 20 për qind të të ardhurave të tyre duke përdorur mjetet e ofruara nga kjo industri e pështirë.

Po ashtu, nëpërmjet "Panama Papers", dhe më pas "Pandora Papers", Konsorciumi Ndërkombëtar i Gazetarëve Investigativë ka treguar se evazoni fiskal në parajsat fiskale është

shumë më sistematik dhe më i përhapur sesa besohet zakonisht. Mijëra biznesmenë, politikanë dhe të famshëm nga e gjithë bota, janë implikuar në atë që përbën një operacion global të pastrimit të parave.

Këto skema kanë lënë një njollë turpi në demokracitë perëndimore dhe institucionet financiare. Të tronditur nga lufta e paprovokuar e Putinit, politikanët perëndimorë kanë nxituar të mbështesin sanksionet të ashpra tregtare kundër Rusisë, duke e përjashtuar shumicën (por jo të gjitha) bankat ruse nga sistemi SWIFT, dhe duke ngrirë pjesën më të madhe të asteve të Bankës Qendrore ruse.

Por do të duhet më shumë guxim për të goditur evazionin fiskal dhe paratë e errëta, tani që ato janë bërë tipare integrale të sistemit aktual financiar. Por nëse ka pasur ndonjëherë një moment për të ndryshuar kursin, koha është tani. Politikë-bërësit perëndimorë mund të frenojnë një skemë të evazionit fiskal, nga e cila përfitojnë padrejtësisht prej vitesh korporatat dhe manjatët më të fuqishëm në botë. Duke vepruar kështu, ata gjithashtu mund të mbledhin të ardhurat nga taksat shumë të nevojshme për të mbështetur infrastrukturën e re dhe programet sociale në vend. Nëse Perëndimi dëshiron ta shohë veten në anën e duhur të historisë, vënia në shënjestër e Rusisë nuk mjafton. Shënim: Daron Acemoglu, profesor i ekonomisë në MIT, dhe bashkautor i librit "Pse dështojnë kombet: Origjina e pushtetit, zhvillimit dhe varfërisë".



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

MKRS-ja kërkon për proces të rregullt e të bazuar në norma statutare të zgjedhjeve në FFK

PRISHTINË, 14 MARS (ER) - Zgjedhjet për kryetar të Federatës së Futbollit të Kosovës janë caktuar më 6 prill. E ashtuqajtura "opozitë" e ka akuzuar kryetarin aktual, Agim Ademi, se po thirr kuvend zgjedhor jo të rregullt, para kohe dhe pa e respektuar periudhën paralajmëruese kohore. Këto akuza vazhdimisht janë hedhur poshtë nga FFK-ja, kurse rreth tyre ka reaguar edhe Ministria e Sportit, e cila ka kërkuar që zgjedhjet të jenë një proces i rregullt. Kredibiliteti, gjithëpërfshirja, respektimi i normave të së drejtës si dhe mundësitë e barabarta në organizata e federata sportive, janë parimet udhëheqëse mbi të cilat Ministria e Sportit ndërton dhe promovon bashkëpunimin me këto federata/organizata. "Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) po e ndjek me vëmendje rrjedhën e zhvillimeve në Federatën e Futbollit të Kosovës, veçanërisht debatet e fundit rreth respektimit ose jo të normave statutare të FFK-së në raport me procesin zgjedhor. Kredibiliteti, gjithëpërfshirja, respektimi i normave të së drejtës si dhe mundësitë e barabarta në

organizata e federata sportive, janë parimet udhëheqëse mbi të cilat Ministria e Sportit ndërton dhe promovon bashkëpunimin me këto federata/organizata. Ne jemi duke punuar intensivisht në reformimin e kornizës së politikave publike dhe asaj ligjore në fushën e sportit e cila do të ndryshojë rrënjësisht shpërndarjen e resurseve publike dhe përdorimin e masave administrative në funksion të arritjes së qëllimeve e objektivave strategjike të Qeverisë për sportin si nxitës i zhvillimit të qëndrueshëm. Ministria e Sportit e kupton mjaft mirë domosdoshmërinë e respektimit të vijës ndarëse në raportet mes autoritetit publik dhe organizatave e federatave sportive dhe po ashtu të obligimeve e të drejtave reciproke në kuptimin e rregullimit ligjor të fushës së sportit me ligjet e Republikës së Kosovës. Ne do të vazhdojmë të sillemi e të veprojmë vetëm brenda këtyre parimeve", thuhet në njoftimin e MKRS-së. "Raportimet se Ministria e Sportit ka zhvilluar akte normative me referencë në një federatë të vetme, janë tërësisht të pavërteta. Citimi i drafteve të akteve normative,



në funksion të rivalizimit të brendshëm, është keqpërdorim dhe keqinformim me copëza të informatave që nuk e prezanton drejtë pozicionin e Ministrisë së Sportit në publik. Ministria e Sportit është autoritet publik dhe ka hierarkinë e saj e cila po ashtu ka të përcaktuara qartësisht autorizimet e veta. Në këtë kontekst, qoftë komunikimi i qëndrimeve në publik apo edhe prezantimi i akteve normative për konsultim me publikun, ka autoritete, mjete e procedura se si realizohet kjo dhe jashtë kësaj, askush nuk mund t'ia prezantojë qëndrimin e Ministrisë në publik. Ne bëjmë thirrje për

proces të rregullt e të bazuar në norma statutare të çdo federate dhe po ashtu nxisim me gjithë fuqinë tonë, funksionalizimin e trupave brenda organeve të organizatave sportive në vend që të zgjedhin çdo rast me pretendime potencialisht të bazuara të normave statutare. Ndërkohë, Ministria e Sportit do të vazhdojë gjithnjë e më fort të thellojë reformat strukturore që prekin kornizën legjislative, të politikave publike dhe të shpërndarjes së resurseve në funksion të ndryshimeve pozitive në sportin tonë, tashmë të domosdoshme", thuhet ndër të tjera në njoftimin e MKRS-së.



Gramoz Vokri nuk e përjashton mundësinë e kandidimit për kryetar të FFK-së

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Gramoz Vokri, djali i legjendës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, ka lënë të nënkuptohet se do të jetë kandidat për kryetar të FFK-së pasi, sipas tij, klubet po e duan ndryshimin. "Puna është se tashmë klubet duan një ndryshim dhe veçse jemi duke biseduar me disa prej tyre. Shkaku i dëshirës së klubeve të bën të konsiderosh këtë mundësi. Por, për momentin nuk ka asgjë zyrtare dhe kur të jetë do të dal publikisht", ka thënë Gramoz Vokri për "Lajmi.net". Zgjedhjet për të parin e FFK-së mbahen më 6 prill, ndërsa momentalisht kandidati i vetëm zyrtarisht është kryetari aktual Agim Ademi.

Koljeviq, MVP i xhiros së 22-të në Superligën e basketbollit

RAHOVEC, 14 MARS - Xhiroja e 22-të në elitën e basketbollit të Kosovës ka dhuruar ndeshje mjaft interesante dhe dramatike. Basketbollisti më i mirë i kësaj xhiroje është Ivan Koljeviq i Rahovecit. Ai ndaj ish-skuadrës së tij, Prizrenit 16, ishte i motivuar, duke e mbyllur ndeshjen me 24



pikë, pesë kërcime dhe tri asistime, ndërsa "Vreshtarët"

shënuan fitore shumë të rëndësishme 95-85. Ndihe të madhe ka dhënë edhe qendra në top-formë, Fisnik Rugova, me 19 pikë, shtatë kërcime dhe shtatë asistime. Derbin e xhiros e ka fituar Trepça, që mundi Golden Eagle Yllin me shifrat 63-67. Te mitrovicasit u dallua Rodney Purvis me 19 pikë,

dy kërcime e dy asistime. Përforcimi i fundit i 'Xehetarëve', sidomos në momentet vendimtare, ishte jetik për skuadrën mysafire, që shënoi fitore shumë të vlefshme. Peja mundi Bashkimin në udhëtim 61:76, në derbin e rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës. Te pejanët më i miri

në parket ishte Courtney Fells me 16 pikë, gjashtë kërcime dhe gjashtë asistime. Ndërkohë, fitore të pritur regjistroi Sigal Prishtina, duke mundur Dritën me 100 pikë dallim, 145-45. Te kryeqytetasit u dallua Meriton Ismaili me 36 pikë, pesë kërcime dhe pesë asistime.

Sonte mësohen edhe dy çerekfinalistë të tjerë

MANCHESTER, 14 MARS - Manchester Unitedi do të kërkojë kualifikimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve. Sonte (e martë) në "Old Trafford" e pret skuadrën e Atletico Madridit. Ndeshja parë e zhvilluar në "Wanda Metropolitano" përfundoi me rezultat 1-1, me Anthony Elanga që si zëvendësues reagoi golin e barazimit, për Atletico kishte shënuar Joao Felix. Unitedi në

këtë ndeshje hyn pas fitores së rëndësishme që e arriti në ndeshjen kundër Tottenham Hotspurit (3-2). Për "Djajtë e Kuq" lajm i mirë është rikthimi i Cristiano Ronaldos që realizoi tre golat e fitores, kurse Atletico Madridi mori një fitore të rëndësishme në përballje me Cadizin (3-2). Unitedi do të jetë pa Mason Greenwood i cili mungon për shkak të një pezullimi të klubit, por Bruno

Fernandes, Luke Shaë dhe Scott McTominay rikthehen në skuadër. Atletico do të jetë pa Yannick Carrasco, Matheus Cunha, Daniel Wass, Sime Vrsaljko dhe Thomas Lemar, ndërsa rikthehen Mario Hermoso, Geoffrey Kondogbia dhe Jose Gimenez.

Të martën takohen:
21:00 Ajax- Benfica
21:00 Man. United - Atl. Madrid



Hyseni, 'ylli i javës' në BKT Superligë

MALISHEVË, 14 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, pas çdo xhiroje japin çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë. Ky çmim për xhiron e 25-të në BKT

Superligë i ka takuar futbollistit të KF Malisheva, Hasan Hyseni. Mesfushori i majtë 24-vjeçar në radhët e KF Malisheva realizoi një supergol në fitoren tejet të rëndësishme që skuadra e tij e arriti si mysafire ndaj Drenicës

me shifrat 3-2. Ai realizoi golin e dytë të skuadrës së tij në minutat e fundit të pjesës së parë, me një gjuajtje të fortë nga një distancë e largët, teksa u dallua edhe për kreativitetin e tij gjatë tërë ndeshjes, ndonëse fusha e lojës

ishte e rënduar për shkak të reshjeve. Pas kësaj fitoreje FC Malisheva e stabilizoi pozitën e saj në elitë me 32 pikë, aq sa kanë edhe Drenica dhe Prishtina. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e KF Malisheva,



Hasan Hyseni, e dha Bekim Kilaj, senior specialist në BKT.

Zëvendësministrja Osmani priti në takim ambasadorën për sport të Republikës së Francës, Laurence Fischer

PRISHTINË, 14 NËNTOR - Zëvendësministrja e MKRS-së, Daulina Osmani, ka pritur në takim ambasadorën për sport të Republikës së Francës, Laurence Fischer, e cila këto ditë po qëndron në Kosovë për të marrë pjesë në konferencën e diplomacisë sportive që organizohet në bashkëpunim mes Ambasadës Franceze në Kosovë dhe Kolegjit AAB. "Bashkë diskutuam për gjendjen aktuale në sport, sukseset e arritura në garat ndërkombëtare dhe proceset e tjera të rëndësishme në zhvillimin e mëtutjeshëm të sportit në Kosovë. Temë diskutimi ishte edhe rëndësia e fuqizimit të sportit për të gjithë dhe zhvillimi i sportistëve të rinj, duke u ofruar atyre mundësi për pjesëmarrje në kampe të ndryshme stërvitore pranë trajnerëve të nivelit të lartë ndërkombëtar, të cilat organizohen në Francë dhe në shtete të ndryshme evropiane", thuhet në njoftimin e MKRS-së.



Ambasadorja Fischer tregoi nismat inovative që po ndërmerret francez në kuadër të organizimit të Lojërave Olimpikë verore "Paris 2024", me qëllim të promovimit sa më të mirë të vlerave të vendit. Duke përmendur përvojat e shtetit francez në organizim të ngjarjeve të mëdha sportive, ajo shprehu gatishmëri për forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve

për ofrimin e mbështetjes në forma të ndryshme për organizim të ngjarjeve të rëndësishme ndërkombëtare sportive edhe në Kosovë. Në këtë takim ajo ishte e shoqëruar nga atashu për bashkëpunim në Ambasadën Franceze, Cecilia Maronnier, si dhe nga menaxherja e projektit në delegacionin për sport të Ministrisë Franceze për Evropë dhe Punë të Jashtme, Marie Roy.

Phoenixi, leksion lakersave, Philadelphia buzëqesh pas kohës shtesë

PHOENIX, 14 MARS - Phoenixi mbetet skuadra më e mirë këtë sezon në NBA, duke qenë ekipi i vetëm që ka kaluar kuotën e 50 fitoreve dhe i vetmi i kualifikuar në "play-off". Suns mundi sot 140-111 lakersat, në një takim të dominuar gjatë gjithë kohës. Booker me 30 pikë e 10 asistime ishte më i mirë për Phoenixin, ekip për të cilin shtatë lojtarë realizuan mbi dhjetë pikë. Në



kahun tjetër LeBron Jamesi realizoi 31 pikë, por që mbetën për statistikë. Fitoi edhe Brooklyn, që mundi me rezultat 110-107 New Yorkun në derbi, sfidë ku u dallua Kevin Durant, autor i 53 pikëve. Fitore në kohën shtesë korri edhe Philadelphia, që mundi me shifrat 116-114 Orlandon. Embiid

realizoi 35 pikë, mbështetur nga Hardeni e Harris me nga 26 pikë secili. Skuadra e Dallasit, falë 26 pikëve të Luka Donçiqit, mundi me rezultat 95-92 Bostonin, ndërsa Memphisi triumfoi 125-118 ndaj Oklahomës, takim ku 45 pikë erdhën nga lojtarët e stolit për miqtë (Bane 21 pikë më i miri).

REZULTATET

Brooklyn - New York	110-107
Detroit - Clippers	102-106
Boston - Dallas	92-95
Orlando - Philadelphia	114-116
Atlanta - Indiana	131-128
New Orleans - Houston	130-105
Oklahoma - Memphis	118-125
Phoenix - Lakers	140-111

Messi dhe Di Maria pritet të largohen nga PSG-ja

Paraqitja e dobët kundër Real Madridit dhe vërshëllimat e marra në "Parc des Princes" mund të jenë gurthemeli i ndërprerjes së aventurës së Lionel Messit te Paris Saint-Germaini. Kampioni argjentinas dhe familja e tij nuk janë rehatuar dot në

qytetin e ri dhe zërat për një rikthim të bujshëm te Barcelonë po ndizen në Spanjë. Sipas gazetarëve iberikë, në fakt, Jorge Messi tashmë ka kontaktuar me drejtuesit blaugrana për ta diskutuar këtë mundësi. "Ai bëri më shumë se një telefonatë para

ngjarjeve të djeshme", ka siguruar gazetari Gerard Romero, shumë i afërt me klubin katalanas. Edhe "El Chiringuito" konfirmon: "Messi do të ishte i lumtur të kthehej te Barcelona, asgjë nuk përjashtohet". Argjentinasi Angel Di Maria do të largohet nga

Paris Saint Germaini. Sipas 'Sport', anëtori tashmë ka marrë vendimin të largohet nga Parisi. Arsyja pse "El Fideo" ka vendosur të largohet është mungesa e minutave edhe përkundër formës së mirë që po kalon.

SHKURT

Operohet me sukses Pranvera Ferataj

Hendbollistja e skuadrës së Istogut, Pranvera Ferataj, është operuar me sukses, pasi që javë më parë kishte këputur tetivën e Akilit dhe nga tani fillon fazën e rikuperimit e cila do t'i zgjasë disa muaj. Ferataj ishte një nga hendbollistet më në formë gjatë këtij sezoni, duke ndihmuar istogaset të arrijnë rezultate pozitive. "Mungesa e saj për një kohë është hendikep i madh për skuadrën tonë, e cila synon që me angazhim maksimal ta kompensojë mungesën e hendbollistëve të lënduara deri në rikthimin e tyre dhe kompletimin e skuadrës. Hendbollistes sonë Pranvera Ferataj i dëshirojmë shërim të plotë dhe rikthim të shpejtë", thuhet në njoftimin e KHF Istogu.

Inzaghi: Berisha bëri dy ndërhyrje fantastike, nuk e nisëm ndeshjen mirë

Interi nxori një barazim në fund të ndeshjes ndaj Torinos (1-1). Pas ndeshjes për "DAZN", trajneri Sinone Inzaghi u shpreh se energjitë e shpenzuara me Liverpoolin ndikuan në këtë takim. "Në pjesën e parë Torino ishte më agresive, edhe pse Berisha bëri dy ndërhyrje të mrekullueshme. Në pjesën e dytë u futëm me një tjetër rritim dhe nëse do ta gjenim golin e barazimit më parë, mund edhe ta fitonim takimin. Për ta fituar titullin kampion duhet të kemi një qasje më të mirë për ndeshjet", ka thënë Inzaghi.

Magathi emërohet trajner i Hertha Berlinit

Lidhej shumë me një nënshkrim të mundshëm me Kosovën, por Felix Magath ka nisur tashmë një aventurë të re. Trajneri gjerman Felix Magath do ta drejtojë skuadrën e Hertha Berlinit. Lajmin e ka bërë me dije faqja zyrtare e Hertha Berlinit përmes një postimi në "Twitter". Klubi gjerman i ka besuar situatën trajnerit të përvojë të madhe, Magath, i cili lidhej me postin e trajnerit të Kosovës për një kohë të gjatë. Hertha është në pozitën e parafundit në tabelë. Veterani do të ketë punë të vështirë

Barça e dëshiron Haalandin ose Salahin

Tashmë të gjithë e dinë se objektivi kryesor i gjigantit katalunas është Erling Haaland. Mediumi spanjoll "As" raporton se blaugranët e kanë në tavolinë alternativën e sulmuesit norvegjez të Borussia Dortmundit. Në fakt, klubi spanjoll do të mundohet ta transferojë sulmuesin e Liverpoolit, Mohamed Salah. Barça po e konsideron mundësinë që t'ia ofrojë gjigantit britanik 65 milionë euro për futbollistin egjiptian, i cili do të hyjë në vitin e fundit të kontratës me "Reds". Për momentin, palët nuk e kanë gjetur ende gjuhën e përbashkët për vazhdimin e kontratës dhe këtë vakum mund ta shfrytëzojë Barça për ta sjellë ish-futbollistin e Baselit, Chelsea, Fiorentinës e Romës në "Camp Nou". Salah është një prej sulmuesve më të rrezikshëm në futbollin evropian.



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar i ri për Pranim dhe Protokollim-SMI

Departamenti: Administratë

Grada: 7

I raporton: Udhëheqësit për Menaxhimin e Informacionit dhe Arkivës Elektronike

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Bën pranimin dhe regjistrimin e postës dhe shkresave në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit;
- Pranon dhe shpërndan postën në mënyrë elektronike përmes SMI-së në BQK;
- Pranon, regjistron, rishikon dhe shpërndan shkresat e hapura;
- Përgatitë dhe dërgon jashtë shkresat dhe materialet përmes SMI-së duke angazhuar shpërndarësin e postës ose shërbimin e kontraktuar për shpërndarje;
- Protokollon në SMI dhe mbanë një kopje të dokumenteve të ndryshme zyrtare, të cilat i dorëzon tek zyrtari i Arkivit për arkivim;
- Bën edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare;
- Përvojë pune profesionale paku 2 vite;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhëve të huaja (anglisht) e dëshirueshme;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë në grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft (Word, Excel, Outlook) si dhe aftësi të përshtatjes për punët me Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, etj.

Të gjithë kandidatët duhet t'i dërgojnë dokumentet e nevojshme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Kopjet e diplomave, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/ nostrifikuar zyrtarisht nga MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 mars 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) ose përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org
- **Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



OBJAVA SLOBODNOG RADNOG MESTA

pozicija: Novi službenik za prijem i protokol-SUI

Odeljenje: Administracija

Stepen: 7

Izveštava: Rukovodiocu za upravljanje informacijama i elektronskom arhivom

Rezime dužnosti i odgovornosti:

- Vršiti prijem i registraciju pošte i spisa u Sistem za upravljanje informacijama;
- Prima i deli poštu na elektronski način putem SUI-a u CBK-u;
- Prima, upisuje, pregledava i raspodeljuje otvorena spisa;
- Priprema i šalje vani spisa i materijale putem SUI-a angažujući poštanskog distributera ili ugovorenu službu za distribuciju;
- Protokolira u SUI-u i drži kopiju raznih službenih dokumenata koje dostavlja službeniku Arhive na arhiviranje;
- Na zahtev rukovodioca, obavlja i druge poslove.

Tražene kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma;
- Radno iskustvu u profesiji od najmanje 2 godine;
- Dobro poznavanje govornog i pisanog albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje stranih jezika (engleskog) je poželjno;
- Dobre komunikacione sposobnosti i spremnost za rad u grupi;
- Dobre tehnološke sposobnosti, programi Microsoft-a (Word, Excel, Outlook) kao i sposobnost prilagodavanja za rad sa Sistemom za upravljanje informacijama, itd.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propatno pismo gde se izražava interesovanje za ovu poziciju;
- Potvrda o radnom iskustvu izdata od strane nadležne institucije/organizacije podržana dokazima iz Trusta;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **29 mart 2022**.
- Apliciranje se može obaviti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>), putem zvanične stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a br. 22. Nijedna druga forma apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem zvanične stranice www.bqk-kos.org
- **Nepotpuna dokumentacija neće biti razmatrana.**

Lokali me qira

Lëshohet lokali me qira. Lokali ka 75 m2. Lokali gjendet tek “REB BULLI”, në Prizren. Për informata mund të na kontaktoni në këta numra të telefonit:

044-514-373 dhe 044-199-707.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Arbër Dakaj shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë, me nr. të dosjes:136889.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli: Zyrtar i Ri për Logjistikë
Divizioni: Divizioni i shërbimeve administrative dhe transportit
Grada: 7
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit

Përmbledhje e detyrave dhe përgjegjësi:

- Planifikon, implementon dhe kontrollon në mënyrë efikase dhe sa më ekonomike logjistikën e qarkullimit të materialit shpenzues, mjeteve materiale si dhe të pasurive jo financiare në pajtim me rregullat në fuqi;
- Planifikon buxhetin vjetor të nevojshëm për furnizimet e rregullta me materiale shpenzues;
- Kujdeset për furnizim me material për zyrë dhe me material tjetër shpenzues në mënyrë efikase sipas kërkesave që vijnë nga njësitë tjera organizative të BQK-së;
- Mirëmban dokumentacionin lidhur me logjistikën duke regjistruar çdo kërkesë me qëllim të raportimit të shpenzimeve periodike;
- Në mungesë të personelit për logjistikë (përgjegjës për depo) realizon kërkesat të cilat vijnë nga stafi i BQK-së për furnizim me material përkatës nga depoja;
- Kujdeset për regjistrimin e hyrjeve-daljeve të materialit në kuadër të deposë dhe i raporton në mënyrë të rregullt javore dhe mujore Udhëheqësit të Divizionit;
- Kujdeset për furnizimin e deposë me material të nevojshëm dhe bënë mirëmbajtjen e deposë në aspektin material dhe administrativ;
- Bashkëpunon dhe asiston zyrtarin administrativ për regjistrimin dhe monitorimin e pasurive jo financiare të BQK-së;
- Bashkëpunon ngushtë me personelin për logjistikë për planifikimin dhe realizimin e kërkesave të rregullta;
- Kryen punë tjera të ngjashme me kërkesë dhe sipas udhëzimeve të Udhëheqësit të Divizionit.

Kualifikimet e kërkuara:

- Diplomë universitare;
- Përvojë pune profesionale paku 2 vite;
- Njohuri të mira të praktikave dhe standardeve për logjistikë që lidhen me natyrën e punës;
- Rrjedhshmëri në të folur dhe në të shkruar të gjuhës shqipe dhe/ose serbe;
- Njohja e gjuhëve të huaja (anglisht) e dëshirueshme;
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë në grup;
- Aftësi të mira të teknologjisë, programet Microsoft (Word, Excel, Outlook) Internet, etj.

Të gjithë kandidatët duhet t'i dërgojnë dokumentet e nevojshme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës të lëshuar nga institucioni/organizata kompetente e mbështetur me dëshmi nga Trust;
- Kopjet e diplomave, diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura/ nostrifikuara zyrtarisht nga MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **29 mars 2022**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) ose përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së, nr.22. Asnjë formë tjetër e aplikimit nuk do të merret parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare www.bqk-kos.org
- Dokumentacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh.**



OBJAVA SLOBODNOG RADNOG MESTA

Pozicija: Novi službenik za logistiku
Odsek: Odsek za administrativne usluge i transport
Stepen: 7
Izveštava: Rukovodiocu Odseka

Rezime dužnosti i odgovornosti:

- Planira, implementira i kontroliše na efikasan i ekonomičan način logistiku prometa potrošnog materijala, materijalnih sredstava i nefinansijske imovine u skladu sa važećim pravilima;
- Planira godišnji budžet koji je potreban za redovna snabdevanja sa potrošnim materijalom;
- Vodi računa o snabdevanju materijalom za kancelariju i drugim potrošnim materijalom na efikasan način prema zahtevima koji dolaze od ostalih organizacionih jedinica CBK-a;
- Održava dokumentaciju vezano za logistiku upisujući svaki zahtev u cilju izveštavanja periodičnih troškova;
- U odsustvo osoblja za logistiku (odgovornog za skladište) realizuje zahteve koji dolaze od osoblja CBK-a za snabdevanje odgovarajućim materijalom iz skladišta;
- Vodi računa o registraciji ulaza i izlaza materijala u okviru skladišta i šalje redovne nedeljne i mesečne izveštaje rukovodiocu Odseka;
- Vodi računa o snabdevanju skladišta potrebnim materijalom i vrši održavanje skladišta u materijalnom i administrativnom pogledu;
- Sarađuje i asistira administrativnom službeniku za registraciju i praćenje nefinansijskih imovina CBK-a;
- Blisko sarađuje sa osobljem za logistiku za planiranje i realizaciju redovnih zahteva;
- Obavlja i druge slične poslove na zahtev i prema uputstvima rukovodioca Odseka.

Tražene kvalifikacije:

- Univerzitetska diploma;
- Radno iskustvu u profesiji od najmanje 2 godine;
- Dobro poznavanje praksi i standarda za logistiku koja su povezana sa prirodom posla;
- Dobro poznavanje govornog i pisanog albanskog i/ili srpskog jezika;
- Poznavanje stranih jezika (engleskog) je poželjno;
- Dobre komunikacione sposobnosti i spremnost za rad u grupi;
- Dobre tehnološke sposobnosti, programi Microsoft-a (Word, Excel, Outlook) Internet, itd.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za apliciranje;
- Propratno pismo gde se izražava interesovanje za ovu poziciju;
- Potvrda o radnom iskustvu izdata od strane nadležne institucije/organizacije podržana dokazima iz Trusta;
- Kopije diploma, dok diplome stečene izvan Republike Kosovo moraju biti službeno priznate/nostifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu i stalnom prebivalištu na Kosovu.

Postupak apliciranja:

- Zadnji rok za apliciranje je **29 mart 2022**.
- Apliciranje se može obaviti on-line (<https://hris.bqk-kos.org>), putem zvanične stranice CBK-a ili putem arhive CBK-a br. 22. Nijedna druga forma apliciranja neće se razmatrati.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem zvanične stranice www.bqk-kos.org
- Nepotpuna dokumentacija neće biti razmatrana.**

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!*

Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!




“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1



“Drenica para gjyqit” – 2



“UÇK-ja para gjyqit” – 3



“Na e ban hallall, Kosove” – 4



*“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,
UÇK - 5*



dramë, 6



Murtaja e Kuqe-7

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

